



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:102732  
Datë: 26.03.2024  
Numri i dokumentit: 05503887

**C.nr.1348/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN- Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil,** gjyqtari Baki Shigjeqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.N. me numër personal ..... me vendbanim në fshatin ..... komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson E.H. avokate nga Prizreni, kundër të paditurve: P.P. me numër personal .... L.P. me numër personal ..... F.P. me numër personal ..... N.P. me numër personal ..... M.P. me numër personal .... N.P. me numër personal ..... I.P. me numër personal ..... M.P. me numër personal .... Sh.P. me numër personal ..... L.P. me numër personal .... D.P. me numër personal ..... K.P. me numër personal ..... që të gjithë me vendbanim në B.D. komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson i padituri L.P. nga fshati ..... komuna e Prizrenit, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, duke vendosur për marrëveshjen e ndërmjetësimit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 26.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. APROVOHET** - Marrëveshja për Zgjidhje të Ndërmjetësuar e arritur pranë Zyrës së Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Prizren, me numër Ndm.nr.35/2024 datë 18.03.2024, në mes të palës paditësit A.N. nga fshati ..... komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson E.H. avokate nga Prizreni, kundër të paditurve: P.P., L.P., F.P., N.P., M.P., N.P., I.P., M.P., Sh.P., L.P., D.P., K.P. që të gjithë me vendbanim në B.D. komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson i padituri Llesh Prekpalaj nga fshati B.D. komuna e Prizrenit, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë.
- II.** Marrëveshja për Zgjidhje të Ndërmjetësuar e arritur pranë Zyrës së Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Prizren, me numër Ndm.nr.35/2024 datë 18.03.2024, do të jetë pjesë e këtij aktvendimi, e cila marrëveshje sipas këtij aktvendimi ka fuqinë e dokumentit përmbarues.
- III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m i**

Paditësi A.N. nga fshati .... komuna e Prizrenit, përmes të autorizurës së tij, av, E.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datën 05.05.2023 kanë ushtruar padi kundër të paditurve: P.P., L.P., F.P., N.P., M.P., N.P., I.P., M.P., Sh.P., L.P., D.P., K.P. që të gjithë me vendbanim në ..... komuna e Prizrenit,, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë, Gjykata ka marrë aktvendim, me të cilin i ka detyruar të paditurit për dhënien e përgjigjes në padi dhe të njëjtën e ka ekspeduar në adresat e dhëna si në padi, nga ana e paditësit. I autorizuari i të paditurve Llesh Prekpanaj, brenda afatit ligjorë ka paraqitur përgjigje në padi, me të cilën e ka pohuar në tersi kërkesëpadinë e paditësit si të

bazuar, ndërsa i ka propozuar Gjykatës që lëndë konform dispozitave ligjore ta referoj në procedurën e ndërmjetësimit.

Gjykata me vendimin e datës 30.01.2024 në pajtim me nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, rasti i është dërguar për zgjidhje pran Qendrës së Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Prizren- zyrtarit të ndërmjetësimit, të cilët këtë rast e kanë zgjidhur sipas nenit 12 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, ashtu që rastin e zgjidhur me ndërmjetësim të datës 18.03.2024, ia kanë dërguar gjyqtarit për aprovim.

Gjykata konstatoi faktin se rasti i zgjidhur me ndërmjetësim i plotëson kushtet ligjore për tu aprovuar nga gjykata, pasi që palët lirisht mund të disponojnë me të drejtat për të cilat janë marrë vesh në zgjidhjen e rastit. Gjykata ka konstatuar se pala e paditur ka legjitimitet real pasivë në këtë çështje kontestimore, pasi të njëjtit janë trashëgimtar të ndjerit- ish pronarit G. (L) P. fakte i vërtetuar nga provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë Dëshmia e Vdekjes e datës 16.04.2021 lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Prizren për të ndjerin G.P. dhe Dëshmia e Vdekjes e datës 01.11.2021 lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Prizren për të ndjerin Franush Prekpalaj. Andaj në kuptim të nenit 15 paragrafi 1 të Ligji për Ndërmjetësim me nr. 06/L-009, të datës 23 korrik 2018, vendosi që ta aprovojë këtë marrëveshje, e cila marrëveshje pas aprovimit me anë të këtij aktvendimi nga ana e gjykatës i ka të gjitha tiparet e dokumentit përmbarues, të kërkuar sipas Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Vendimi mbi shpenzimet u muar në kuptim të nenit 452.2 të LPK-ës.

Nga të cekurat më lartë, e konform nenit 411.1 të LPK dhe nenit 8 par.1 lidhur me nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësimin 06/L-009, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2023:102732, 26.03.2024**

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.